

REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA  
 QEVERIA E KOSOVES - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA  
 MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPESINOR  
 MINISTARSTVO SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA  
 MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING

Njësia Org. Org.Jedincira Org.Unit SP-02 Nr.Prot. Broj Prot Prot.No. 7569-2/19

Nr. i faqeve Broj stranca No pages 05 Data: Datum. Date: 14.05.20

Prishtinë / a



**Republika e Kosovës**  
 Republika Kosova - Republic of Kosovo  
 Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE AMBIENTIT  
 MINISTARSTVO INFRASTRUKTURE I ŽIVOTNE SREDINE  
 MINISTRY OF INFRASTRUCTURE AND ENVIRONMENT

*Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Permanentni Sekretara / Office of the General Secretary*

|                        |  |
|------------------------|--|
| DATË/A:                | 13.05. 2020  |
| REFERENC-Ë:            | 19/7569/MIA  |
| PËR/ZA/TO:             | " Wallingford International- Kosovo L.L.C." Sh.p.k.<br>Prishtinë |
| CC:                    |  |
| PËRMES/PREKO/THROUGH:  |  |
| NGA/OD/FROM:           | Izedin Bytyqi, Sekretar i Përgjithshëm i MIA                     |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | Vendim   |



Ministria e Infrastrukturës dhe Ambientit, e ka shqyrtuar Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis të dërguar nga kompania e juaj sipas kërkesës me nr.prot.: 19/7569/MIA dhe pas shqyrtimit të bërë ka vendosur sikurse në vendimin e bashkangjitur kësaj letërpërcjellëse.

1. Vendimi për Pëlqim Mjedisor për shfrytëzimin e mergelëve në karrierën " Çupeva Verilindore " - Klinë,K.K. Klinë 2. Shtojcë: Obligimet dhe detyrimet që dalin nga Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 (neni 31. pika 1, 2. dhe neni 35).

Me respekt,

Faqe 1 nga 5



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria – Vlada - Government*

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE AMBIENTIT**  
**MINISTARSTVO INFRASTRUKTURE I ŽIVOTNE SREDINE**  
**MINISTRY OF INFRASTRUCTURE AND ENVIRONMENT**

*Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Permanentni Sekretara / Office of the General Secretary*

Në bazë të nenit 29.paragrafi 1, të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr.03/L-025, nenit 22 dhe nenit 25 të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 03/L-214 dhe nenit 44. të LPA (Nr.05/L-031), Ministria e Infrastrukturës dhe Ambientit, bie këtë:

**V E N D I M**

**APROVOHET** kërkesa e Kompanisë " Wallingford International- Kosovo L.L.C." Sh.p.k. Prishtinë për Pëlqim Mjedisor për shfrytëzimin e mergelëve në karrierën " Çupeva Verilindore " - Klinë,K.K. Klinë

**A r s y e t i m**

Ministria e Infrastrukturës dhe Ambientit ka shqyrtuar kërkesën, Raportin e VNM-së, dokumentacionin e dorëzuar të kompanisë " Wallingford International- Kosovo L.L.C." Sh.p.k. Prishtinë për Pëlqim Mjedisor për shfrytëzimin e mergelëve në karrierën " Çupeva Verilindore " - Klinë,K.K. Klinë, në pjesët e ngastrave kadastrale nr.00730-0, nr.00728-0, nr.00731-0 ,nr.00710-11, nr.00720-0, nr.00718-1, nr.00719-0, nr.00732-0,nr.00733-0 Zona kadastrale Dollc , K.K. Klinë me sipërfaqe të përgjithshme prej  $S=1888681.559$  m<sup>2</sup> .

Në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-214 për VNM , neni 20 , është mbajtur debati publik, dhe me këtë rast, Ministria e Infrastrukturës dhe Ambientit i jep **Pëlqim Mjedisor**, për shfrytëzimin e mergelëve në karrierën " Çupeva Verilindore " - Klinë,K.K. Klinë, nën kushtet si vijon:

Faqe 2 nga 5



- Gjatë punës (procesit teknologjik) duhet të ndërmerren të gjitha masat për evitim të ndotjes së mjedisit nga mbeturinat e ngurta, evitim nga derdhja e vajrave të makinave, evitim nga derdhja e karburanteve të posaçërisht gjatë furnizimit të makinave;
- Të bëhet sistemi për grumbullimin e ujërave nga sipërfaqet operacionale, dhe të hapet kanali për rreth shfrytëzimit të mergeleve me qëllim të mbledhjes së ujërave atmosferike të ndotura dhe të orientohen në pusët sedimentuese për trajtimin e ujërave, në afat kohor prej dy muajsh nga dita e marrjes së këtij pëlqimi mjedisor;
- Të rregullohen pajimet për trajtimin e ujërave atmosferike nga sipërfaqet operacionale (pusët sedimentuese), në afat kohor prej dy muajsh nga dita e marrjes së këtij pëlqimi mjedisor;
- Të vendosen pajimet adekuate për mbeturina të ngurta dhe lëngta;
- Në kohra të nxehta të bëhet spërkatja e rrugës (pjesa e pa asfaltuar), kohë pas kohe, me ujë, me qëllim të zvogëlimit të pluhurit gjatë transportit, gjithashtu kamionët gjatë transportit të mergeles duhet të mbulohen me mbulesë adekuate;
- Ndalohet eksploatimi i mergeles brenda dyqind (200) metra prej ndonjë pende ose rezervuari;
- Pas shfrytëzimit të mergeles të kryhet rikultivimi i zonës duke iu përshtatur projektit për rikultivim;
- Të bëhet thurra e ngastrës me tel gjëmbor.

Aplikuesi përpos kushteve të lartshënuara duhet të u përmbahet edhe kushteve të paraqitura në raportin e VNM-së.



**Operatori është i obliguar me Ligj, që të aplikoj për Leje Mjedisore**

Ky Pëlqim Mjedisor vlen për dy vite konform nenit 25 te Ligjit për VNM Nr. 03/L-214.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nxjerrjes.

**Këshilla Juridike:**Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicoj konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë në afat 30 ditësh nga dita e pranimit e të njejtit.

Ministria e Infrastrukturës dhe Ambientit

Nr.: 19/7569/ZSP/A24/20 datë: 13.05.2020

Prishtinë

T'i dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës
2. Komisionit për VNM/VSM
3. Inspektoratit
4. Kabinetit të Ministrit
5. Arkivit të MIA-së

Izedin BYTYQI

Sekretar i Përgjithshëm



2. SHTOJCË : Detyrimet që dalin nga Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr.03/L-025 për procedurën e mëtejshme, (neni 31. pika 1, 2. dhe neni 35).

### **Neni 31.**

#### Leja Mjedisore

1. Lëshimi në punë i objektit të ndërtuar apo i stabilimenteve dhe pajisjeve që kanë qenë objekt i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, nuk mund të filloj veprimtarinë pa marrjen e lejes mjedisore.

2. Leja mjedisore lëshohet për periudhën pesëvjeçare, sipas procedurës së përcaktuar për pranim teknik të objekteve dhe stabilimenteve ose pas kryerjes së punës provuese deri në gjashtë muaj, por gjithësesi para lëshimit në punë.

### *Neni 35.*

#### Planet e intervenimit në rast të aksidentit mjedisor

1. Për rastet e aksidentit të mundshëm mjedisor ose të ndonjë ndodhie që posaçërisht e rrezikon mjedisin ose shëndetin e njeriut, Qeveria nxjerr plane të intervenimit dhe informon Kuvendin.

2. Planet e intervenimit nga paragrafi 1. të këtij neni përmbajnë: llojet e rrezikshmërisë; procedurat dhe masat për zbutjen dhe eliminimin e pasojave të drejtpërdrejta për mjedisin dhe shëndetin e njeriut; subjektet për zbatimin e masave të caktuara; përgjegjësitë dhe kompetencat lidhur me zbatimin dhe mënyrën e ndërmarrjes së masave për intervenim të cilat zbatohen sipas ligjit.

3. Planet e intervenimit për prodhimet, pajisjet dhe stabilimentet, të cilat me veprimtarinë e tyre mund të shkaktojnë ndotje të mjedisit, i harton prodhuesi.

4. Komuna është e obliguar të nxjerr planin e intervenimit për territorin e vet.

5. Përmbajtjen e planeve, procedurat dhe masat e zbatimit, subjektet e zbatimit të masave të caktuara, llojet e pajisjeve, stabilimenteve, dhe llojet e proceseve prodhuese sipas paragrafit 3. të këtij neni, Ministri e përcakton me akt nënligjor.

